$$PR = 85 \% Mo$$

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një

justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

#### 4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

### D. DHËNIA E KONTRATËS

#### 23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

#### 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

### DH. ANKESAT

#### 25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së

parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.





---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

[Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

[Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës](#)

[Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial](#)

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

[Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike](#)

[Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut](#) të ekzekutimit

[Shtojca 8: Formulari i Termave](#) të Referencës

Shtojca 9: [Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve](#)

[Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit](#)

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

---

**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

|                                    |  |
|------------------------------------|--|
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit |  |
| Nënshkrimi                         |  |
| Vula                               |  |
| Datë _____                         |  |

**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| 1                                  | 2                      | 3     | 4               | 6                                |       |
|------------------------------------|------------------------|-------|-----------------|----------------------------------|-------|
| Artikulli                          | Përshkrimi i shërbimit | Sasia | çmimi për njësi | Çmimi total për shërbim (3 x 4X) |       |
| 1.                                 |                        |       |                 |                                  |       |
| 2.                                 |                        |       |                 |                                  |       |
| 3.                                 |                        |       |                 |                                  |       |
| 4                                  |                        |       |                 |                                  |       |
|                                    | Çmimi total (Mallrat)  |       |                 |                                  | _____ |
| Çmimi Neto pa TVSH                 |                        |       |                 |                                  |       |
| TVSH (%)                           |                        |       |                 |                                  |       |
| Çmimi total me TVSH:               |                        |       |                 |                                  |       |
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit |                        |       |                 |                                  |       |
| Nënshkrimi                         |                        |       |                 |                                  |       |
| Vula                               |                        |       |                 |                                  |       |

|            |  |
|------------|--|
| Datë _____ |  |
|------------|--|

**Sqarime:**

1. Në çmim të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor dhe nën ligjore në fuqi në lidhje me këtë shërbim që ka të bëjë me pagat, shtesat mbi pagë për turnet e II-<sup>ta</sup>, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet për karburantin, shpenzimet për autorizimet e autobлиндave, shpenzimet administrative si dhe fitimi i shoqërisë, etj.
2. Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për 1 njësi me shërbim (Turni I-<sup>rë</sup>, nga ora 14:<sup>00</sup> - 16:<sup>00</sup>) dhe 1 njësi me shërbim (Turni II-<sup>të</sup>, nga ora 19:<sup>00</sup> - 21:<sup>00</sup>) nga e Hëna deri të Shtunë pa festa zyrtare, me koeficient (2) punonjës. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizën e kostos mujore të kryerjes së shërbimit.

Preventiv të koston për 1 njësi në muaj për 2 orë shërbim transporti me 2 punonjës për Turni I-<sup>rë</sup>

| <b>Kosto Shërbim Shoqërimi (nga e hëna ne te shtunë pa festa zyrtare)</b> |  |
|---------------------------------------------------------------------------|--|
| A. Paga baze mujore                                                       |  |
| Paga baze ore                                                             |  |
| Ore ne dite 2 (dy)                                                        |  |
| Kosto per rruge per 2 punonjes                                            |  |
| Kosto shtese per Turni II/ore                                             |  |
| Sigurimet shoqerore                                                       |  |
|                                                                           |  |
| Total shuma                                                               |  |
| Shpenzime Mjet blind                                                      |  |
| Fitim dhe shpenzime admin                                                 |  |
| Total shuma                                                               |  |
|                                                                           |  |
| <b>Totali A+B+C</b>                                                       |  |

Preventiv të koston për 1 njësi në muaj për 2 orë shërbim transporti me 2 punonjës për Turni II-<sup>të</sup>

| <b>Kosto Shërbim Shoqërimi (nga e hëna ne te shtunë pa festa zyrtare)</b> |  |
|---------------------------------------------------------------------------|--|
| A. Paga baze mujore                                                       |  |
| Paga baze ore                                                             |  |
| Ore ne dite 2 (dy)                                                        |  |
| Kosto per rruge per 2 punonjes                                            |  |
| Kosto shtese per Turni II/ore                                             |  |
| Sigurimet shoqerore                                                       |  |
|                                                                           |  |
| Total shuma                                                               |  |
| Shpenzime Mjet blind                                                      |  |

|                           |  |
|---------------------------|--|
| Fitim dhe shpenzime admin |  |
| Total shuma               |  |
|                           |  |
| <b>Totali A+B+C</b>       |  |

#### Analiza e kostos

- Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 113, datë 01.03.2023, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe Udhezimit Nr.150 datë 16.08.2024 të Ministrit të Brendshëm.
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomikë ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek ( e kërkuar në dokumentat e tenderit ) .
- Klasifikimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertes së dhënë në total.

**SHËNIM:** Operatorët Ekonomikë krahas Formularit të Ofertës dhe preventivit të publikuar në DST duhet të paraqesë edhe:

- Analizën e Çmimit me përllogaritje konkrete aritmetike, në të cilën të jenë përfshirë të gjitha detyrimet ligjore si:

- Shpenzime për pagë bazë;
- Shtesë mbi pagë për turnin II;
- Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%,
- Fitim dhe Shpenzime administrative
- Shpenzime transporti + mjete blind

---

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]



---

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|-------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |
|                                                             |                                                                       |                                                      |                                                                |

### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

### **Nënshkrimi**

### **Vula**

---

## Shtojca 5.

*(<sup>3</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

### **DEKLARATË**

#### **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt .....është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>4</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

**Shtojca 6.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Specifikime teknike**

**Te realizohet sherbimi e shoqerimi i vlerave monetare si me poshte me :**

Zyra te Sherbimit ndaj Klientit **[KNK]** dhe Arkat.

-Grupi i shoqerimit duhet te jete pajisur me mjete mbrojtese, me Uniforme dhe Dokument Identifikimi si dhe mjete te tjera logjistike sic parashikohet ne Ligjin Nr.75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike".

-Te shoqeroje vlerat monetare qe i jane besuar dhe te siguroje jeten e personelit gjate transportit te vlerave monetare.

-Per transportin e vlerave monetare, Ofertuesi duhet te pajise punonjesit e sherbimit me arme krahu, sipas pecaktimeve ligjore te Ligjit Nr.75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike".

Ofruesi i Sherbimit duhet te plotesoje kerkesat e meposhteme :

- a) Te jete i Licencuar nga autoritetet kompetente per ushtrimin e Funksionit si roje i ruajtjes dhe Sigurise Fizike **(Kopje e Licences)**
- b) Te reflektoje nje sjellje korrekte dhe te respektueshme .
- c) Mjeti i identifikimit i punonjesve te sherbimit gjate gjithë kohes se Sherbimit duhet te mbahet ne vend te dukshem.
- d) Gjate gjithë kohes se Sherbimit punonjesi i Kompanise SHPSF , duhet te respektojë rregullat e brendeshme te OSHEE sh.a.
- e) Punonjesi i Ofruesit te Sherbimit duhet te jete i afte te reagoje dhe veproje gjithmone ne perputhje me Instruksionet e personave pergjegjes te percaktuar nga OSHEE sh.a.
- f) Te gjithë punonjesit e Ofruesit te Sherbimit te kerkuar duhet te jene te pajisur me Uniformen dhe te gjitha materialet e nevojeshme llogjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" si dhe cdo Akti tjeter Nen / Ligjore perkatese qe del per SHPSF.
- g) Te kerkojne nga punonjesit te zbatojne rregullat e brendeshme te Objektit.
- h) Transporti i mjeteve monetare do te kryhet dy here ne dite, sipas vendodhjes se arkës se percaktuar ne tabelen e Shtojces Nr.1 .
- i) Transporti do te kryhet ne perputhje me Legjislacionin ne fuqi.
- j) Mjeti dhe numri i punonjesve qe do te kryejne sherbimin e transportit te vlerave monetare do te behet ne perputhje me Legjislacionin ne fuqi si dhe cdo Akti tjeter Nen / Ligjore perkatese qe del per SHPSF.
- k) Oraret e levizjes do te jene: Koha orare e shoqerimit te vlerave monetare do te jete :
  - Turni i pare nga ora 14:00-16:00
  - Turni i dyte nga ora 19:00-21:00

---

**l)** Shoqërimi do të kryhet nga dita e hënë deri ditën e shtunë pa festa zyrtare në të gjitha pikat sipas tabelës në shtojcën NR.1

**m)** Shoqërimi duhet të kryhet nga një mjet i kompanisë së shoqërimit, mjeti duhet të jetë i blinduar, i loguar, në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare për kryejën e shoqërimit të vlerave monetare.

## **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

##### Kerkohej shërbimi i shoqërimit të vlerave monetare për rajoni Durrës

Shërbimi kërkohet të kryhet në keto vende dhe sipas turneve në tabelë nga dita e hënë deri ditën e shtunë pa festa zyrtare:

|                                 |              |              |
|---------------------------------|--------------|--------------|
| 1.Durrës KNK 1 (rruga e portit) | Turni i Pare | Turni i dyte |
| 2.Durrës KNK 2 (njesia)         | Turni i Pare | Turni i dyte |
| 3.Durrës KNK 3                  | Turni i Pare | Turni i dyte |
| 4.KNK Kavaje                    | Turni i Pare | Turni i dyte |
| 5.KNK Kushe Kruje               | Turni i Pare |              |
| 6.Kruje ARKE                    | Turni i Pare |              |
| 7.KNK MANZE                     | Turni i Pare |              |
| 8.KNK SHIJAK                    | Turni i Pare | Turni i dyte |
| 9.KNK Rrogozhine                | Turni i Pare |              |
| 10. KNK Golem                   | Turni i Pare |              |

\*Afati i Kontratës : 24 muaj nga dita e lidhjes së kontratës.

---

## Shtojca 8

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

#### 1. Objekti dhe Qellimi i Sherbimeve :

“Ruajtja dhe shoqërimi vlerave monetare Drejtoria Rajonale e OSSH Durres - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj.

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

#### 2. Objektivat:

Ofertuesi i Sherbimit do te siguroje ruajtjen dhe shoqërimin e vlerave monetare te KNK-ve dhe Arkave te Drejtorise Rajonale te OSHEE Durres si dhe punonjesit ( arketare) gjate kohes qe ata jane duke performuar detyrat e tyre në keto ambiente të KNK-ve dhe Arkave sipas Tabelës së Shtojcës 7.

#### 3. Detyrat e Kontraktorit:

Kontraktori ka për detyrë:

1. Cdo punonjes i Sherbimit, Titullari i Subjektit te SHPSF-se, si dhe Drejtuesi Teknik duhet te kryejne me pergjegjesi te gjitha detyrat e percaktuara ne Ligjin Nr.75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike” i ndryshuar si dhe ne Aktet Nenligjore te dala ne zbatim te tij.
2. Ruajtja dhe shoqërimi i vlerave monetare të mbledhura nga KNK dhe Arkat do të bëhet çdo ditë nga e Hëna në të Shtunë pa festa zyrtare nga vendndodhja e KNK dhe Arkave deri në bankat respektive me të cilat ka kontratë OSHEE sh.a.
3. Gjithashtu Ofruesi i Shërbimit do të sigurojë ruajtjen fizike të punonjësve të KNK dhe arkave (arkëtarët) gjatë kohës që ata janë duke përformuar detyrat e tyre në ambientet e OSHEE, Drejtoria Rajonale Durres si dhe gjatë transportit të vlerave monetare deri në përfundim të dorezimit të këtyre vlerave pranë bankave respektive.

#### **Koha e Shërbimit:**

Operatori Ekonomik duhet te ofroje sherbimin e kerkuar nga e hena ne te shtune pa festa zyrtare perkatesisht :

- Turni i pare do te kryhet nga Ora 14.00 - 16.00
- Turni i dyte do te kryhet nga Ora 19:00 - 21:00

#### **Shperndarja**

Sipas tabelës se publikuar nga Autoriteti Kontraktor ne kete DST.

#### **Vendi dhe kryerja e sherbimeve :**

Arkat dhe Qendrat KNK te Drejtorise Rajonale te OSHEE Durres si dhe bankat respektive ku do te behet derdhja e vlerave monetare.

## Shtojca 9

---

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

## **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kriterë duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

---

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- 2.1.1** Liçensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, nënkategoria **1.3.B**, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike dhe transport vlerash monetare”, lëshuar nga QKL/ QKB;
- 2.1.2** Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që disponon Certifikatë të titullarit të subjektit në fushën e veprimtarisë së aktivitetit 1.3 B, lëshuar nga Dr. e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bazë të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) azhurnuar me ligjin 90/2023 si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij).
- 2.1.3** Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që disponon Certifikatë e drejtuesit teknik në fushën e veprimtarisë së aktivitetit 1.3 B, lëshuar nga Dr. e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bazë të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) azhurnuar me ligjin 90/2023 si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij).

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- 2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë sa 100 % e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- 2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

- 2.2.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 10 të DST-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

**2.3 Kapaciteti teknik**



**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh ekonomik, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë akt – marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik, si dhe në rast se është realizuar si nënkontraktor duhet të paraqesë miratimin e autoritetit kontraktor.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku të përfshihet Titullar Subjekti dhe Drejtuesi Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 10 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

**2.3.3** Operatori Ekonomik *ofertues* duhet të vërtetojë që disponon Licensë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP) konform Ligjit Nr. 54/2024 datë 30.05.2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të vlefshëm me fushë mbulimi në qarkun ose qytetet ku ndodhen objektet.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim performance lëshuar në jo më parë se muaji Qershor i vitit 2025 nga Drejtoria e Policisë Durrës për kategorinë e Licencës 1.3B, konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Ku duhet të jepet informacioni për disponimin e:

- Jo më pak se **1 (një)** përgjegjës shërbimi,
- Arme krahu **6 (gjashtë)** copë,
- Arme Brezi **4 (katër)** copë,
- Jo më pak se **10 (dhjetë)** punonjës shërbimi të licencuar,

- 
- Jo më pak se 5 (pesë) mjete të blinduara.
  - Qendër Kontrolli në Qarkun Durrës,
  - Ka punuar mirë gjatë ushtrimit të aktivitetit.
  - Të disponojë jo më pak se 10 jelek antiplumb (faturë ose vertetim nga Drejtoria e Policisë Durrës)
  - Të disponojë jo më pak se 10 shkopinj gome (faturë ose vertetim nga Drejtoria e Policisë Durrës)
  - Të disponojë jo më pak se 10 hekura lidhës (pranga) (faturë ose vertetim nga Drejtoria e Policisë Durrës)

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në këto bashkim.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim performance leshuar në jo më parë se muaji Qershor i vitit 2025 nga Drejtoria e Policisë Tiranë për kategorinë e Licencës 1.3B, konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Ku duhet të jepet informacioni për disponimin e:

- Jo më pak se 1 (një) përgjegjës shërbimi,
- Arme krahu 4 (katër) copë,
- Arme Brezi 2 (dy) copë,
- Jo më pak se 6 (gjashtë) punonjës shërbimi të licencuar,
- Jo më pak se 3 (tre) mjete të blinduara.
- Qendër Kontrolli në Qarkun Tiranë,
- Ka punuar mirë gjatë ushtrimit të aktivitetit.
- Të disponojë jo më pak se 6 jelek antiplumb (faturë ose vertetim nga Drejtoria e Policisë Tiranë)
- Të disponojë jo më pak se 6 shkopinj gome (faturë ose vertetim nga Drejtoria e Policisë Tiranë)
- Të disponojë jo më pak se 6 hekura lidhës (pranga) (faturë ose vertetim nga Drejtoria e Policisë Tiranë)

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në këto bashkim.*

Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Qendrës së Menaxhimit të Shërbimeve (QMSH) për qarkun ku subjekti ka selinë dhe Aktin e Miratimit të Zyres së Menaxhimit të Shërbimeve (ZMSH) të SHPSF, për Qarqet e tjera të Shqipërisë sipas udhëzimit të Ministrisë të Punëve të Brendshme nr. 150 datë 16.08.2024 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike" (Durrës dhe Tiranë).

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 8 automjete të blinduar për transportin e vlerave monetare, mjete të cilat duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Lejet e qarkullimit dhe certifikat pronësie nga Drejtoria e Transportit Rrugor
2. Leje Drejtimi e përdoruesit të mjetit të blinduar për çdo mjet.
3. Certifikatë e Kontrollit Teknik për secilin mjet (SGS).

---

4. Siguracë të vlefshme për secilin mjet.

5. Taksat vjetore të paguara për secilin mjet.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë 8 Autorizime të vlefshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përdorimin e mjeteve të blinduara.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë Certifikata të lëshuar nga prodhuesi i mjetit të blinduar (**kompania e specializuar për transformimin e mjeteve nga mjete normale në mjete të blinduara**) për minimalisht 8 automjete të blindura, me normë blindimi jo më të vogël se BR6, sipas normave Europiane të EN 1522, dhe EN 1063 ose me standarde të ngjashme me këto për automjete të blinduar.

2.3.7 Me qëllim parandalimin e veprimeve kriminale Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kapacitete sipas qarqeve si më poshtë:

- Për Qarkun Durrës faturë tatimore blerje ose deklarata doganore të mallit për 5 copë GPS; 5 copë DVR, 20 kamera dhe 10 armë zjarri.
- Për Qarkun Tiranë faturë tatimore blerje ose deklarata doganore të mallit për 3 copë GPS; 3 copë DVR, 12 kamera dhe 6 armë zjarri.

Operatori Ekonomik për të vërtetuar faktin e pronësise së armëve duhet të disponojë gjithashtu dhe dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim nga drejtoria e përgjithshme e policisë për blerjen e armëve të zjarrit.
- Kontrata shitblerje Armë me një shoqëri të licensuar
- Fatura tatimore për blerjen e armëve.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.**

**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim.**

**Shtojca 10.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| Identifikimi                                                                                                                                              | Përgjigjja     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | -----          |
| Numri NIPT/et:                                                                                                                                            | -----          |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar                                                                                                           | -----<br>--    |
| Përfaqësuesi (emri):                                                                                                                                      | -----          |
| Telefoni:                                                                                                                                                 | -----<br>-     |
| E-mail:                                                                                                                                                   | -----<br>----- |

## B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|-----------------------------------------------------------|
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |
|                                     |         |                             |                                                           |

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|------------------------|--------|----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |
|                        |        |                                                                      |                                      |

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

#### Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

